



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-24792 dt. 14.07 2020

Mbledhja e Jashtëzakonshme

Kuvendi Komunal

08.07.2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes se jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **08.07.2020**

Mbledhjen e kryesoi: **LABINOT HALILAJ – Kryesues**

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 25 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Miratimi i deklaratës në mbrojtje të vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës fjalën ja kalojmë Kryetarit Komunës Ramiz Lladrovci:

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci : Të nderuar asamblistë,

Të nderuara drejtoresha, drejtor, zyrtarë,

Zonja zotërinj,

Sot, jemi në këtë seancë, për të miratuar Deklaratën, e cila është e motivuar nga ndjenja e thellë e dhimbjes që shkakton padrejtësia. Zyra e Prokurorit të Specializuar ka publikuar njoftimin për një

aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli.

Lufta mbrojtëse e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe e përkrahur nga forcat e NATO-së, ishte luftë e drejtë dhe e pastër. Motivi i saj ishte çlirimi nga okupatori dhe pavarësia. Lufta mbrojtëse e UÇK-së, ka qenë e imponuar nga dhuna jonjerëzore me veprime gjenocidi nga okupatori, ka qenë e drejtë dhe do të mbetet përherë e tillë.

Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri, mbështetjen e plotë për z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli, të cilët janë ndër themeluesit dhe udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke shprehur besimin e palëkundur në pafajësinë e tyre.

Si përfaqësues të qytetarëve të njërës nga komunat më të goditura nga gjenocidi serb, ndjehemi të fyer e të prekur thellë, me këto akuza të pakonfirmuara.

Andaj ju ftoj ta votoni Deklaratën, si solidarizim me Presidentin Hashim Thaçi dhe liderin e PDK-së, Kadri Veselin. Ju faleminderit!

Adem Bucolli-Përshendetje për te gjithë për njëzet vite nuk është bërë aq sa duhet për mbrojtjen e vlerave të luftës çlirimtare të UÇK-së, dhe faji është i përbashkët për të gjithë, sepse duhet të jemi kembngules në mbrojtjen e vlerave të UÇK-së, shoqata janë të thirrura drejtpërdrejt në UÇK-së dhe janë përfaqësitë të UÇK-së me gjithë respektin që kem për shoqatat sepse edhe unë personalisht jam pjesë e shoqatës të veteraneve, mua dhe bashkëluftëtareve të mi mu na dhemb shumë ngritja e akt akuzave ndaj dy liderëve Hashim Thaqit dhe Kadri Veselit pa të cilët do të ishte e pa kuptim edhe shtet bërja ne duhet ti tregojmë botës se ne jemi çlirimtar dhe jo ata që kanë bërë krime dhe gjenocid mbi popullatën e pa fajshme dhe nga këtu ftoj prokurorin e gjykatës speciale dhe te shikoj nëpër fshatrat e Kosovës anembanë dhe sidomos në Drenicë dhe e shihni se sa masakra sa njerëzit janë vrare dhe janë të zhdukur, sepse po te ishim ne agresori NATO neve do na kundërvijë jo atyre

Petrit Gashi: I nderuar kryetar Lladrovci,

I nderuar kryesues Halilaj,

Të nderuar kabinet i kryetarit,

Të nderuar koleg dhe kolege asamblist, Draft - Deklarata në të cilën sot kjo assemble është mbledhur në përkrahje të pa rezervë të luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të protagonisteve të saj, në të cilën kohëve dhe viteve të fundit është atakuar padrejtësisht nga

mekanizma të drejtësisë ndërkombëtarë do ta përkrahim sepse mendojmë se lufta e UÇK-së dhe UÇK-ja në tersi është identiteti me i pastër i historisë së re të Kosovës. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë e drejtë, e pastër si loti, e domosdoshme, e pritur, dhe e rritur në gjirin e popullit. Ata që hedhin dyshime mbi pastërtinë e saj, ata që hedhin dyshime mbi organizimin e saj, ata kanë hedhë dyshime edhe mbi identitetin e një kombi, sepse kjo luftë mblodhi trimat dhe trimëreshat me të mëdha të kombit tonë. Kjo luftë bashkojë vizionaret që lanë gjurme në histori, dhe kjo luftë e lindur dhe e rritur nga populli u fitua, sepse ishte e popullit. Është e pashembullt në histori që pikërisht këtë luftë dhe këta luftëtarë trima që derdhen gjakun për lirinë e vendit të tyre të atakohen aq shumë nga drejtësia ndërkombëtarë. Megjithatë tek ne ndodhi siç e kemi parë në procese të njëpasnjëshme nga gjykata e Hagës kundër komandanteve të luftës të cilën nuk e donin gjykimin por persekutimin e tyre. Pra kjo ndodhi edhe kundër ish-Kryeministrit Haradinaj, Fatmri Limajt dhe madje dënoj një të pafajshëm siç ishte rasti me bashkëqytetarin tonë Haredin Bala. Pra, ne nuk hezituam të ju përgjigjemi drejtësisë ndërkombëtarë asnjëherë, për të dëshmuar se lufta jone ishte e drejtë dhe pastër si loti. Prandaj, pavarësisht asaj që ndodhi gjatë këtyre gjykimeve, Ushtria Çlirimtare e Kosovës as nuk u zbeh e as nuk u dorëzua, sepse ajo ishte tanimë histori e shkruar, dhe historia nuk ndryshohet me kamuflime e fakte të rrejshme. Gjykata raciste në të cilën ju vu mbi shpinë Kosovës në historinë më të re të saj, është gjykata me e padrejtë në historinë e njerëzimit dhe e cila po tenton të zbeh lavdin e përjetshme dhe të pavdekshme që ka krijuar Kosova. Të nderuar kolege dhe kolege, Ushtria Çlirimtare dhe lufta e saj për lirinë është e shenjet dhe ajo nuk zbehet nga asgjë. I vetmi agresor, i vetmi vend që ka shkaktuar gjenocid ndaj popullit tonë në luftën e fundit, është Serbia dhe atje duhet të kërkojë kriminelet Gjykata e ashtu quajtur Speciale. Nuk e di si nuk ndihen me turp ata që merren me luftëtarët e UÇK-së kur e dine se sa krimet i ka kryer Serbia në Kosove dhe askush nuk është dënuar. Masakrat e Poglekut, Abrise, Çikatoves, Prekazit, Recakut, Izbices e shume e shumë të tjera po anashkalohen nga gjykimi, sepse ju paska nxen rrugë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, kjo forcë ushtarake e popullit që fitoj lirinë e vet dhe të popullit të vet. Pra, kjo është hipokrizia ndërkombëtarë. Dhe në këtë pjesë fajtoret mund të janë edhe brenda nesh, sepse nuk kemi bërë sa duhet për ta ruajtur dhe për ta mbrojtur atë. Sot, ata gjykatës, prokurore e hetues të cilët kanë ngritë dyshime mbi pastërtinë e luftës së UÇK-së dhe të luftëtareve të saj, nuk e di a ndjehen me turp dhe a mendojnë se krimet e kryera në Kosovë janë bërë nga serbet dhe jo nga shqiptaret. UÇK-ja nuk ka luftuar në serbi, nuk ka vrarë serb në serbi, nuk ka dhunuar gra e

vajza siç e kanë bërë fashistet serb, por kanë dalur hapur në mbrojtje të familjeve të tyre, të vendit të tyre dhe të lirisë së tyre. Është e turpshme që kjo gjykatë anashkalon masakruesit e Valmirit të vogël 18 muajsh dhe të nënës së tij në të cilën e tronditi botën dhe nuk dënohen. Është e turpshme që sulmuesit e Drenushës së vogël 6 vjeçe që ja këputi dorën, e duke e varrosur edhe dorën e vet për tu shndërruar si varri me i çuditshme në botë nuk gjykohen dhe nuk dënohen. Është totalisht raciste që ata që e zhduken doktorin e popullit Dr. Hafir Shalën vetëm se u kujdes për shëndetin e pacienteve shqiptarë, ata që vranë mësuesin e pafajshëm Halit Gacin, ata që vranë e masakruan poetin Ymer Elshani as nuk akuzohen e as nuk dënohen. Është e papranueshme që ata që vranë e masakruan mbi 1600 fëmijëve, mbi 11 mijë civil, e dhunuan mbi 20 mijë gra madje edhe duke i vrarë e masakruar qindra prej tyre janë në liri dhe as nuk akuzohen e dënohen. Është hipokrite që ata që dogjën çdo gjë që doli përpara, ata që larguan mbi një milion njerëz nga Kosova duke e shndërruar vendin në një tokë pa njerëz, lihen të lirë dhe në anën tjetër tentojnë ta dënojnë e akuzojnë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, identitetin tone kombëtar e krijuesen e shtetit tonë. Pra kjo është e turpshme, megjithatë se bashku duhet ta fitojmë edhe këtë betejë. Por askush nuk mund të shuaj e nuk mund ta njollos me një gjykim sakrificën e Komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, guximin dhe dijen e Fehmi e Xheve Lladrovci, luftën dhe heroizmin e Luan e Shkëlzen Haradinajt, devotshmërinë dhe përpjekjen e Zahir Pajazitit, etjen për liri të Ymer Alushanit, e dëshirën për tri shkronjat të heroit 15 vjeçar Mentor Gashi që ra ne altarin e lirisë. Pra, askush. Dhe ata që mendojnë që duke dënuar individ nuk dënohet UÇK-ja, janë njerëzit me tëpaditur në botë, sepse UÇK-në e linden emra të mëdhenj të sipërpërmendur por e mbajtën gjallë luftëtarët trima që sot janë afër nesh, madje disa prej tyre edhe në këtë sallë. **Të nderuar të pranishëm,** Tendencia e Gjykatës Speciale për të barazuar krimet gjakatare serbe me lirisdashësit tonë janë përpjekje të kota dhe të ndikuara nga lobet ruso-serbe, lobe në të cilën i kemi mundur edhe ne vitin 1999. Tendencia për të etiketuar ushtrinë çlirimtare të Kosovës janë të kota, sepse asnjëherë çlirimtarët nuk do të barazohen me kriminelet. Tendencia për të dënuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës me fakte të rrejshme e me aktakuza të kundërligjshme janë të kota, sepse UÇK-ja është vet populli dhe askush në histori nuk ka mundur të dënojë një popull të tërë. Askush më mirë se populli ynë dhe se protagonistet e UÇK-së nuk e dinë sakrificën tonë për lirinë, madje sakrifice, që na ka përcjellë edhe 21 vite pas luftës. Askush më mirë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk e njeh dhembjen por edhe krenarin e popullit tone në të cilën ka bashkëjetuar edhe 21 vite pas lufte.

Askush me mire se ne dhe se ushtaret e UÇK-së nuk e dinë vlerën dhe çmimin e lirisë, sepse ata edhe 21 vite pas mbeten ushtarë të vërtetë duke u bërë urë për proceset e Kosovës edhe pse me plagët në trup, dhembjen në shpirt, varfërinë në shtëpi por krenar sepse ishin dhe mbeten çlirimtarë. Por, mos harroni se kjo Gjykatë është edhe një plagë me shumë në plagën e Kombit dhe të luftëtarëve tonë. Tek lexoja Draft – Deklaratën në mbështetje të UÇK-së mu kujtua axha im, Gjenerali Abedin Gashi i cili vdiq në nëntorin e vitit të Kaluar, e ku 20 vite jetoj pa veshket e tij që ja fali lirisë por kurrë nuk u ankua për plagët e tij, dhe a e dini pse? Sepse ishte Çlirimtarë, dhe çlirimtarët janë mësuar të janë krenar dhe ta pamposhtur. Pra të tillë janë edhe qindra e mijëra çlirimtarë që kurrë nuk u dorëzuan dhe e tillë është edhe UÇK-ja sot kur po sfidohemi edhe nga Gjykata raciste Speciale. **Të dashur të pranishëm,** Ne do jemi deri në momentin e fundit të jetës tonë në mbështetje të luftës tonë çlirimtarë, sepse ajo ishte e pastër, sepse ishte dhe mbetet identiteti i shtetit tonë, sepse është dhe mbetet simbol i lirisë dhe Pavarësisë sonë, por kurrë nuk do i shkarkojmë nga përgjegjësia edhe ata që e votuan këtë gjykatë raciste duke e ditur nga fillimi që është kundër UÇK-së dhe protagonisteve të saj. Edhe Ata përfaqësues të Komunës tonë që fatkeqësisht me votën e qytetareve të Drenasit ngritën dorën për votimin e gjykatës Speciale mbajnë përgjegjësinë historike se i kanë shërbyer kësaj të keqe të madhe, dhe Ne këtë duhet ta pranojmë hapur dhe duhet të ju themi hapur. Ne kemi bërë gabime edhe si qeverisje dhe këtë duhet ta pranojmë, se për 21 vite me radhe nuk kemi miratuar ligje në mbrojtje të vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe nuk kemi dhënë sa duhet për familjet e dëshmorëve, veteraneve e invalidëve të UÇK-së. Për 21 vite me radhe me shumë kemi zgjedhur heshtjen, edhe kundër UÇK-së kanë trumbetuar zëra të brendshme e të jashtëm duke hedhur baltë mbi vlerat e saj dhe mbi protagonistet e saj. Dhe kjo mendoj është gabim. Sepse kushdo në botë po të kishte një ushtri të tillë të cilave veç zemrave të popullit fitoj edhe partneritetin me të madh ndërkombëtar të udhëhequr nga NATO e SHBA, do ta kishte vendosur në piedestalin më të lartë të saj në mënyrë që të jetë e paprekshme nga të gjithë. Mirëpo, edhe pse kemi bërë gabime ndoshta të paqëllimshme mund të përmirësojmë atë, sepse Ligji për vlerat e luftës është i domosdoshëm. Megjithatë, si asamblist i INICIATIVËS QYTETARE PËR DRENASIN, si aktivistë që prej fillimit kam protestuar kundër kësaj gjykate raciste, e mbështes çdo përpjekje tonë shtetërore, kombëtare e popullore në shërbim të luftës së shenjt të UÇK-së. Jam i bindur se edhe kësaj radhe, qoftë z. Thaqi. qoftë z. Veseli e kush do qoftë tjetër do të dalin faqebardhe nga një proces totalisht i montuar kundër vlerës me të madhe të

kombit tonë, dhe jam i bindur se ashtu siç kemi fituar luftën në vitin 1999 do ta fitojmë edhe këtë betejë të radhës kundër atyre që po tentojnë ta njollosin emrin e UÇK-së. Në këto momente të vështira për vendin tonë, Uniteti jonë politik dhe koordinimi jonë kombëtare është mese i nevojshme, prandaj për menaxhim të brendshme politik mund të kemi mendime e veprime të ndryshme por për luftën e drejtë të UÇK-së dhe luftëtarëve të saj jemi një ZË dhe një TRUP i përbashkët. Rrnoftë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Lavdi dëshmoreve të kombit dhe të rënëve për liri. Faleminderit!

Beqir Kiqina- jemi sot këtu të gjithë sëbashku të miratojmë këtë propozim sepse lufta e ushtrisë qllirimtarë të kosovës ishte luftë e pastër dhe e drejt për liri e vendit tonë.

Figura e komandantit legjendar se bashku më shkoët e tij bëri luftën më të drejt në ballakanin e evropës. Adem Jashari dhe bashkluftetaret e tij si Hashim Thaqi, Kadri Veseli ,Ramush Haradinaj, Fatmir Limaj dhe të gjithë ata të cilët u rreshtuan prane tri shkronjave të arta UÇK, këta luftetar nuk bën krime ne Reqak ,Abri,Rezall dhe askund tjetër po ata mbrojtën dhe bën me të mirën të mundshme ,lufta e ushtirës qllirimtare është dëshuar edhe me rastin e Fatmir Limajt dhe Ramush Haradinajt icili rreth nje dekade përsekutime ,përseri doli i pa fajshëm,dhe ju ftoi që të gjithë një zëri të votojmë deklaratën për mbrojtjen e vlerave të ushtrisë qllirimtare të kosovës.

Bedri Nika- përshendetje për të gjithë ,të nderuar me lejoni të rikujtoj se krijimi i të ashtuqujtures gjykat kushtetuese specilaje vjen pas raportuesit të këshillit të Evropës Dik Marti icili pretendoi se krimet kundër civileve rrembim torturim trafikim organesh janë të kryera nga pjesëtarët e UÇK-së përpjekjet e popullit të kosovës për të marr profilin e një vendi eurpian dhe një vendi të lirë vazhduan me përpjekje disa vjeqare.Ngritja e një propozim akuze ndaj pjestarëve të UÇK-se siq është zoti Thaqi dhe zoti Veseli por ndaj luftës tonë të paster për liri dhe pavarasi nuk është hera e parë që kjo luft po testohet nëpër gjykata a nderkombetare siq është edhe ajo e Hagës dhe këty kisha dashur të citoi edhe fjalet e presidenti Ibrahim Rugova gjatë ballafaqimit me kasapin e ballakanit dhe i cili kishte theksuar së UÇK –ja nuk është organizat terroriste dhe asnjë departament i asnjë shteti se ka shpallur si të tillë,ajo ka qënë organizat e krijuar nga populli,nga patriotet të cilët luftuan për lirin e vendit për LDK kjo deklrat mbete relevante dhe ende e vlefshme.

Edhe për kohën që po kalojmë tani ashtu siç është shprehur edhe kryetari Mustafa se në këtë betej duhet të jemi bashkë të gjithë një zëri, gjithashtu edhe unë kërkoi unitet politik dhe qytetëra që të mbrojmë vlerat e ushtrisë çlirimtare.

Kryesusi i Kuvendit Labinot Halilaj- Me kërkesën e kryetarit të Komunesë, kam thirrur séancën e jashtzakonshme me piken e vetme të rendit të ditës “Miratimi i deklarates në mbrojtjen të vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”. Të nderuar, ideja për themelimin e Gjykatës Speciale, apo siç tashmë është emëruar me ligj nga Parlamenti i Kosovës si “Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar”, doli pas një rezolute në Këshillin e Evropës që kërkonte hetime që pretendojnë se pjesëtarët e ish-UÇK-së kanë kryer krime lufte. Të nderuar, për mua është ironike kjo rezolutë e Këshillit të Evropës, ironike për shumë fakte ngase a ishim në pushtuesit apo të pushtuarit, a ishim në ata të cilët luftuam për lirinë e njëpopulli apo ishim në ata të cilët luftuam për cenimin e lirisë të popullit tjetër, a ishim në ata të cilët debuam me mijra banorë, vram, maskruam, dhunim dhe zhdukëm me mijra të tjerë apo ishim viktimë. E të nderuar të pranishëm ironia nuk mbaron këtu, duke e pasur bekimin edhe të institucioneve tona një pyetje se cili ka qenë qëllimi i themelimit të kësaj gjykate, a do të duhet të ekzistonte një e tillë, a është kjo gjykate për të ndarë drejtësi a për të bërë padrejtësi, a nuk i mjaftojnë botës pafajësia e ish-pjestarëve të UÇK-së e deshmuar në Gjykatën e Hagës, andaj edhe sa do të duhet të perballemi në situatën e njëjtë mbi vërtetësinë se lufta e UÇK-së ishte luftë e pastër dhe ish-pjestarët e UÇK-së nuk kanë bërë krime lufte. Zonja dhe zotërinjtë pretendimet e prokurorit të kësaj gjykate të pretenduara si gjoja për krime lufte ndaj Presidentit të vendit z. Thaci si dhe ish-Kryetarit të Parlamentit njihërit Kryetarit të Partisë Demokratike si Partia me e madhe opozitare në Parlamentin e Kosovës, nga këndvështrimi im le që nuk ngjasojnë këto pretendime nga një Prokuror por më shumë ngjasojnë pretendime nga një politikan, kur dihet fakti se negociatat me shtetin Serb ishin pranë finalizimit dhe rolin kyq nga pala Kosovare e kishin po këto dy figura. Zonja dhe zotërinjtë të nderuar të pranishëm, por në prap se prap duhet të e ruajmë qetësinë, se ne besojmë në vlerat e popullit tonë, në traditat e trashiguara ndër breza, në ato vlera ku as edhe një herë nuk jemi edukuar se kur të rritemi në duhet të vrasim femijë, në ato vlera që kur të rritemi në duhet të vrasim gra, në ato vlera që kur të rritemi të vrasim pleqë, në ato vlera që kur të rritemi të masakrojmë, në ato vlera kur të rritemi të vrasim njëzëri të pafajshëm, e të cilat vlera u kultivuan edhe në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Andaj të nderuar të pranishëm që mos ta zgjase më shumë, duke e mbështetur deklaratën për mbrojtjen e vlerave të

luftese se UCK-se e propozuar nga Kryetari i Komunes z. Lladrovci citoj ‘se nese do te duhej te perndjeken krimet e luftese atehere adresa do te duhej te ishte Serbia, e nese keto pretendime tentohen te behen ndaj ish pjestareve te UCK-se, me kete po behet edhe nje krim ndaj lirinashve si dhe ndaj popullit tone’.

Nën kryetari i komunës Nazmi Hasi-pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit lexoi deklaratën për mbrojtjen e vlerave të ushtrisë çlirimtare të Kosovës .

DEKLARATË

1. Konfirmojmë qëndrimin tonë dhe bindjen e paluhatshme se lufta mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, përkrahur nga forcat e NATO-së, prirur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe bota demokratike, ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës, kundër regjimit gjenocidal të forcave ushtarake dhe policore të Serbisë.
2. Vlerësojmë të paprecedent publikimin e njoftimit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar për një aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli. Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri, mbështetjen e plotë dhe besimin e palëkundur në pafajësinë e tyre.
3. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta çmojë lart bashkëpunimin e institucioneve kosovare dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare përgjatë këtyre njëzet vjetëve, duke përfshirë Dhomat e Specializuara.
4. Si përfaqësues të qytetarëve të komunës së Drenasit, të njërës nga komunat më të goditura nga gjenocidi serb, ku janë kryer dhjetëra masakra të tmerrshme nga forcat ushtarake e policore serbe, ndjehemi të fyer dhe të prekur thellë, sepse ende asnjë akuzë nuk është ngritur ndaj planifikuesve, urdhërdhënësve apo kryesve të krimeve të gjenocidit serb, pra, ASNJË i dënuar nga drejtësia ndërkombëtare.
5. Kujtojmë masakrën e Vërbocit, Shtuticës, Poklekut, Abrisë, Likoshanit e dhjetëra masakra tjera, ku u vranë, dogjën, dhunuan dhe u zhdukën gra, burra, pleq, duke mos kursyer as foshnja e fëmijë. Nga të gjitha këto masakra të dëshmuara e të argumentuara, nuk ka ende asnjë akuzë ndërkombëtare apo të dënuar nga organet e drejtësisë.

6. Forcat ushtarake serbe dhe artileria e rëndë e tyre, shkaktoi miliarda euro dëme të luftës, duke shkatërruar dhe djegur mbi 70% të vendbanimeve, duke përfshirë shtëpi, ndërtesa, lokale, biznese, shkolla, objekte kulturore, fetare etj.
7. Përveç masakrave dhe krimeve në njerëz, agresori serb gjatë luftës plaçkiti edhe trashëgiminë materiale dhe kulturore duke marrë me vete shënimet kadastrale si: Shënimet e kadastrit përshkrues (dokumentacionin e viteve 1950-1960); Planet origjinale të viteve 1961-1967 -Regjistrat e fletëparaqitjeve - Regjistrat ABC të pronarëve; Regjistrin e parcelave; regjistrin e kulturave dhe klasave; Regjistrat e ndërrimeve kadastrale; Regjistrat e fletëposeduesve për secilin pronar dhe zonë kadastrale; Dokumentacionin e Komasacionit; Aktvendimet mbi eksproprijimet të objekteve shoqërore; Dokumentacioni dhe elaborate i reformës agrare, kolonizimi, arondacionet, *eksproprijimet*, riorganizimit të kooperativave bujqësore, konfiskimet, shqyrtimin e uzurpimeve, fondet e tokave; Evidencë e përgjithshme e pasurisë së patundshme mbi të cilën ekziston e drejta e pronësisë së qytetarëve edhe personave civil - juridik. Këto dokumente edhe përkundër marrëveshjes së nënshkruar, akoma nuk janë kthyer.
8. Si përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhur në mënyrë demokratike, bëjmë thirrje për unitet mes qytetarëve dhe bashkërendim të angazhimeve ndërmjet institucioneve të të gjitha niveleve dhe partive politike, për të mbrojtur vlerat e luftës dhe pastërtinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 50 min.

Procesmbajtëse:


Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit


Labint Halilaj